REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:072105
Datë: 23.02.2019
Numri i dokumentit: 00231730

P.nr.09/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN, gjyqtari **Sulltan Dobraj**, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër të pandehurit **J.L.** për veprën penale të kanosjes nga neni185 par.1. të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me aktakuzën e PTH-se nga Peja **PP/II.nr.2645/18** të dt.**21.12.2018**, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.**31.01.2019**, me pjesëmarrjen e prokurores se shtetit Lumturije Vuçetaj, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij av. Haxhi Çekaj, me dt.31.01.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**13.02.2019** përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri **J.L.** i lindur me dt..., i biri i M. dhe nënës R., posedues i nr.tel...., shqiptarë, shtetas i Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më dt.25.11.2018 rreth orës 19:40 në Deçan, më qëllim të frikësimit, më fjalë e kanosë tjetrin se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarën H. L., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara kishte një pronë të veten të cilën më vite të tëra ia kishte dhënë në shfrytëzim të pandehurit dhe një javë para ditës kritike e kishte thirr në tel. të pandehurin dhe i kishte thënë se tokën nuk do ta japi më sepse ia kam dhënë djalit të axhës N.L., dhe i pandehuri i drejtohet më fjalët '' kom me ta qi nonën, dhe kom me ti qu cuklat më temel, rrospihe, kurvë '', për çka kishte frikësuar të dëmtuarën.

- **Me çka ka kryer vepre penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së**

2019:072106

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 7, 17, 41, 50, 51 ,58, 73, 74, nenit 185 par. 1 te KPRK-ës, nenit 365, 453, 463 par 2 të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N
ME DËNIM ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKQYRJEN NGA SHERBIMI SPROVUES

I. I përcakton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj, me kusht,** të cilin dënim fare **nuk do ta mbaj,** nëse në afat prej **1 (një) viti,** nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do te mbikëqyret nga shërbimi sprovues.

III. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës se verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale.

IV. **URDHËROHET**, i pandehuri që te mbaj kontaktin me shërbimin sprovues, dhe i njëjti njoftohet se ne rast se i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata mund te revokoj dënimin me kusht.

V. E dëmtuara H. L., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

VI. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguan shumën prej 25 (njëzet e pesë) euro dhe në emër te fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 (tridhjete) euro, ndërsa për shpenzime te procedurës penale gjykata do te vendos me aktvendim te veçantë nëse gjen shpenzime te tilla.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën **PP/II.nr.2645/18** të dt.**21.12.2018**ka akuzuar J.L. për shkak te veprës penale te kanosjes nga neni 185 par.1. te KPRK-ës, ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata Themelore Pejë dega në Deçan e dt.31.01.2019, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit te aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit fillestar konform nenit 248 paragraf 4 te KPP-ës.

2019:072106

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron se: Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë e ky pranim i fajësisë mbështetet me provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes unë ne tërësi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj, gjykatës i propozoi qe i njëjti te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit, lidhur me vendimin për dënim si rrethana lehtësuese te merr pranimin e fajësisë, sjelljet e mira gjatë shqyrtimit.

Mbrojtësi i te pandehurit av. Haxhi Çekaj ne fjalën përfundimtare deklaroi se : gjykata te merr parasysh faktin se i mbrojturi im e pranoi fajësinë me vullnetin e tij, dhe i propozoi gjykatës që te ketë parasysh kërkim faljen, dhe premtimin e tij se nuk do te kryen vepra te tilla ne te ardhmen, e posaçërisht nuk do te kitë probleme me te dëmtuarën pas këtij rasti.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaron se: shprehi keqardhje, jam shumë i penduar, dhe nuk do ta përsëris këtë vepër , i kërkoj falje te dëmtuarës.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi i ka vërtetuar këto gjendje faktike: Më dt.25.11.2018 rreth orës 19:40 në Deçan, më qëllim të frikësimit, më fjalë e kanosë tjetrin se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarën H. L., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara kishte një pronë të veten të cilën më vite të tëra ia kishte dhënë në shfrytëzim të pandehurit dhe një javë para ditës kritike e kishte thirr në tel. të pandehurin dhe i kishte thënë se tokën nuk do ta japi më sepse ia kam dhënë djalit të axhës N.L., dhe i pandehuri i drejtohet më fjalët '' kom me ta qi nënën, dhe kom me ti qu cuklat më temel, rrospihe, kurvë '', për çka kishte frikësuar të dëmtuarën.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në bazë të nenit 257 te KPPRK-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë në bazë te nenit 248 te KPPK-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bëre në mënyre vullnetare andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurave të veprave penale kanosjes neni 185 paragraf 1 KPRK-ës, gjykata ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës i veprës penale, ka qenë i vetëdijshëm për veprimet që i ka ndërmarrë, i ka dashur pasojat e shkaktuara me ato veprime, ka qenë përgjegjës dhe i përgjegjshëm në kohën e kryerjes se veprave penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për veprën penale, i ka shqiptuar dënimin me kusht me burgim si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, dhe ne këtë mënyrë do te ndikoj ne arritjen e qëllimit të dënimit, te parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të ndaloi persona tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqërorë për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

2019:072106

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjellja e të pandehurit që ka qenë gjatë gjithë procedurës korrekte, pastaj kërkim falja nga ana e të pandehurit, pendimi i të pandehurit, premtimi i të pandehurit se në të ardhmen nuk do te kryej vepra të tilla, ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Në bazë te nenit 51 par.4.te KPK-ës, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht për dënimin me burgim .

Në bazë të nenit 58 te KPK-ës gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovës sepse gjykata ka konsideruar se inkuadrimi i të pandehurit në shoqëri është më i lehtë dhe më i mirë përmes mbikëqyrjes nga shërbimi sprovës.

Gjykata në bazë te nenit 463 të KPPK-ës të dëmtuarën H. L. nga fsh. Lumbardh K-Deçan e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Në bazë të nenit 453 të KPRK-ës gjykata të pandehurin e ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguan shumën prej 25 (njëzetepesë) euro dhe në emër te fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 (tridhjete) euro, ndërsa për shpenzime te procedurës penale gjykata do te vendos me aktvendim te veçantë nëse gjen shpenzime te tilla.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.09/2019 te dt.13.02.2019

Sekretarja juridike
Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I
Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :
Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e pranimit te kopjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës se Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore Pejë dega ne Deçan.

2019:072106